

VENDIM
Nr. 74, datë 6.2.2026

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN,
NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE
NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 41, të kreut I, pas fjalëve “... (CFSP) 2025/1199 ...” shtohen “... (CFSP) 2026/88 ...”.

2. Në aneksin 41, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2026/88, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2026/88 i datës 9 janar 2026

që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/254 mbi masat kufizuese në lidhje me situatën në Guatemalë

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 12 janar 2024, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2024/254 ⁽¹⁾.
- (2) Në bazë të një nishikimi të listës së personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve të përcaktuara në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2024/254, duhet të përditësohen regjistrimet për pesë individë. Për më tepër, masat kufizuese të përcaktuara në atë Vendim duhet të zgjaten deri më 13 janar 2027.
- (3) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2024/254 duhet të ndryshohet në përputhje me rethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi (CFSP) 2024/254 ndryshohet si më poshtë:

- (1) në nenin 9, paragrafi i parë, data ‘13 janar 2026’ zëvendësohet me atë të ‘13 janarit 2027’;
- (2) Shtojca ndryshohet në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Nënshkruar në Bruksel, më 9 janar 2026.

Për Këshillin

President

M. RAOUNA

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2024/254 i 12 janarit 2024 mbi masat kufizuese në lidhje me situatën në Guatemalë (OJ L, 2024/254, 15.1.2024, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2024/254/oj>).

SHTOJÇI

Në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2024/254, nën titullin "A. Personat Fizikë", shtënimet numër 1, 2, 3, 7 dhe 8 zëvendësohen me shënimet përkatëse si më poshtë:

Emri	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
1. Maria Consuelo PORRAS ARGUETA DE PORRES	Pozicioni(et): Prokurorë e Përgjithshme e Guatemalës, Drejtues i Ministrisë Publike (Ministerio Público) të Guatemalës Data e lindjes: 23.8.1953 Shtetësia: Guatemalense Numri i identifikimit kombëtar: 242159605 (pasaportë) Gjinia: femër	Në cilësinë e saj si Prokurorë e Përgjithshme e Guatemalës, funksionaria në e lartë civile në Ministrinë Publike (Ministerio Público) të Guatemalës (ekuivalente me Drejtuesin e Zyrës së Prokurorit Publik ose Kryeprokurorin), María Consuelo Porras Argueta De Porres (e njohur edhe si "Porras") është e përfshirë në përpjekjet për të përmbytur rezultatet e raundit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve të mbajtura në qershor dhe gusht 2023, duke përfshirë përmes hetimeve penale të pazazuara që synojnë Gjykatën Supreme/ të Lartë Zgjedhore, partinë politike Movimiento Semilla dhe Presidentin Arévalo. Për më tepër, nën drejtimin e saj, Ministria Publike ka nisur procedura arbitrare kundër gazetarëve, prokurorëve, gjyqtarëve dhe aktivistëve të shoqëisë civile të pavarur, përfshirë udhëheqës indigenë dhe studentë. Për rrjedhojë, María Consuelo Porras Argueta De Porres është përgjegjëse për veprime që minojnë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe transferimin paqësor të pushtetit në Guatemalë.	2.2.2024

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
2.	Ángel Arnaldo PINEDA ÁVILA	Pozicioni(et): Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë Publike (Ministerio Público) të Guatemalës Data e lindjes: 10.5.1975 Shtetësia: Guatemalase Numri i identifikimit kombëtar: 238937186 (pasaportë) Gjinia: mashkull	Ángel Pineda Ávila është Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë Publike (Ministerio Público) të Guatemalës (ekuivalente me Zyrën e Prokurorit Publik). Ai është autoriteti i dytë në hierarki në Ministrinë Publike pas Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtues i Sekretariatit të Përgjithshëm të atij institucioni. Në këtë dësi, Ángel Pineda Ávila është i përfshirë në përpjekjet për të përmbysur rezultatet e raundit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve të mbajtura në qershor dhe gusht 2023, duke përfshirë përmes hetimeve penale të pabazuara që synojnë Gjykatën Supreme/të Lartë Zgjedhore, partinë politike Movimiento Semilla dhe Presidentin Arévalo. Në dhjetor 2023, ai mori pjesë në një konferencë për shtyp ku Ministria Publike paraqiti pretendime se rezultatit i raundit të parë të zgjedhjeve në qershor 2023 ishte i pavlefshëm. Në vitin 2025, Ángel Pineda Ávila u angazhua në hetimin e pabazuar ndaj udhëheqësve indigenë të cilët u akuzuan për terrorizëm për veprimet e tyre në mbrojtjen e rezultateve të zgjedhjeve të vitit 2023. Për rrjedhojë, Ángel Pineda Ávila po angazhohet në veprime që minojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe transferimin paqësor të pushtetit në Guatemalë.	2.2.2024

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
3.	José Rafael CURRUCHICHE CUCUL	Pozicioni(et): Drejtues i Zyrës së Prokurorisë së Posaçme kundër Pandëshkueshmërisë, Ministria Publike (Ministerio Público) e Guatemalës Data e lindjes: 28.7.1970 Shtetësia: Guatemalase Numri i identifikimit kombëtar: 229488307 (pasaportë) Gjinia: mashkull	José Curruchiche Cucul është Drejtues i Zyrës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Pandëshkueshmërisë (FECI), e cila vepron në varësi të Ministrisë Publike (Ministerio Público) të Guatemalës (ekuivalente me Zyrën e Prokurorit Publik). Nën drejtimin e tij, FECI ka udhëhequr hetimin e vazhdueshëm për krijimin e partisë politike Movimiento Semilla të Presidentit Arévalo. Ai mori pjesë personalisht në bastisjen e kryer nga Ministria Publike në ambientet e Gjykatës Supreme/ të Lartë Zgjedhore, e cila përfshinte hapjen e kutive të vulosura të votimit. Përveç kësaj, ai qënë i përfshirë në kërkesën për pezullimin e personalitetit juridik të Movimiento Semilla në korrik 2023. Për më tepër, në dhjetor 2023 ai mori pjesë në një konferencë për shtyp ku Ministria Publike paraqiti pretendime se rezultati i raundit të parë të zgjedhjeve në gershor 2023 ishte i pavlefshëm. Ai ka qenë personalisht i përfshirë në hetime dhe ndjekje penale të pabazuara ndaj autoriteve të zgjedhura në mënyrë demokratike, ish-përfaqësuesve të medias (si gazetari José Rubén Zamora), si dhe ndaj operatorëve të drejtësisë, veçanërisht në hetimet dhe ndjekjen penale të pabazuara ndaj atyre që luftuan kundër korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar Kundër Pandëshkueshmërisë në Guatemalë (CICIG). Nëpërmjet këtyre veprimeve, José Curruchiche Cucul është i përfshirë në përpjekjet për të përmbytur rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2023 në Guatemalë. Për mëdhojë, ai është përgjegjës për veprime që minojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe transferimin paqësor të pushtetit në Guatemalë.	2.2.2024

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
7.	Ricardo Rafael MÉNDEZ-RUIZ VALDÉS	Pozicioni(et): President, Fundación contra el Terrorismo), FCT Data e lindjes: 9.10.1959 Shtetësia: Guatemalase Numri i identifikimit kombëtar: 268287872 (pasaportë) Gjinia: mashkull Individë të lidhur: Raúl Amílcar Falla Ovalle Entitete të lidhura: Fundación kundër Terrorizmit (Fundación contra el Terrorismo), FCT Rrjetet sociale: https://x.com/mendezruiz	Ricardo Méndez-Ruiz Valdés është President i Fondacionit Kundër Terrorizmit (Fundación contra el Terrorismo), FCT. FCT është përfshirë në një fushatë ndjekesh penale me motive politike, të udhëhequra nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Guatemalës kundër gazetarëve, udhëheqësve indigenë, prokurorëve dhe gjyqtarëve që kanë qenë të angazhuar në ekspozimin e korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë në Guatemalë, si dhe kundër qeverisë së zgjedhur në mënyrë demokratike të Guatemalës, përfshirë Presidentin Bernardo Arévalo. FCT ka filluar një mori hetimesh penale kundër operatorëve të drejtësisë, gazetarëve dhe përfaqësuesve të qeverisë përmes paraqitjes së kallëzimeve penale dhe duke vepruar si palë e tretë paditëse në procedurat penale që nuk respektojnë të drejtat themelore të të pandehurve. Nëpërmjet këtyre veprimeve, Ricardo Méndez-Ruiz Valdés është angazhuar në veprime që minojnë sundimin e ligjit në Guatemalë, duke përfshirë persekutimin dhe frikësimin e përfaqësuesve të medias, shoqërisë civile dhe të avokatëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve.	12.6.2025

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
8.	Raúl Amílcar FALLA OVALLE	Pozicioni(et): Përfaqësues ligjor, Fundacióni kundër Terrorizmit (Fundación contra el Terrorismo), FCT Data e lindjes: 9.11.1971 Shtetësia: Guatemalase Numri i identifikimit kombëtar: 179421166 (pasaportë) Gjinia: mashkull Individi të lidhur: Ricardo Méndez-Ruiz Valdés Entitete të lidhura: Fundacióni kundër Terrorizmit (Fundación contra el Terrorismo), FCT Mediat sociale: https://x.com/RaulFalla31	Raúl Falla Ovalle është përfaqësuesi ligjor i Fundacióni kundër Terrorizmit (Fundación contra el Terrorismo), FCT. FCT është përfshirë në një fushatë ndjekesh penale me motive politike, të udhëhequra nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Guatemalës kundër gazetarëve, udhëheqësve indigjenë, prokurorëve dhe gjyqtarëve që kanë qenë të angazhuar në ekspozimin e korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë në Guatemalë, si dhe kundër qeverisë së zgjedhur në mënyrë demokratike të Guatemalës, përfshirë Presidentin Bernardo Arévalo. FCT ka filluar një mori hetimesh penale kundër operatorëve të drejtësisë, gazetarëve dhe përfaqësuesve të qeverisë përmes paraqitjes së kallëzimeve penale dhe duke vepruar si palë e tretë paditëse në procedurat penale që nuk respektojnë të drejtat themelore të të pandehurve. Nëpërmjet këtyre veprimeve, Raúl Falla Ovalle angazhohet në veprime që minojnë sundimin e ligjit në Guatemalë, duke përfshirë persekutimin dhe frikësimin e përfaqësuesve të medias, shoqërisë civile dhe të avokatëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve.	12.6.2025*



2026/88

12.1.2026

COUNCIL DECISION (CFSP) 2026/88
of 9 January 2026
amending Decision (CFSP) 2024/254 concerning restrictive measures in view of the situation in
Guatemala

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 12 January 2024, the Council adopted Decision (CFSP) 2024/254 ⁽¹⁾.
- (2) On the basis of a review of the list of natural and legal persons, entities and bodies set out in the Annex to Decision (CFSP) 2024/254, the entries for five individuals should be updated. Moreover, the restrictive measures set out in that Decision should be extended until 13 January 2027.
- (3) Decision (CFSP) 2024/254 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Decision (CFSP) 2024/254 is amended as follows:

- (1) in Article 9, first paragraph, the date '13 January 2026' is replaced by that of '13 January 2027';
- (2) the Annex is amended in accordance with the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 9 January 2026.

For the Council
The President
M. RAOUNA

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2024/254 of 12 January 2024 concerning restrictive measures in view of the situation in Guatemala (OJ L 2024/254, 15.1.2024, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2024/254/oj>).

ANNEX

In the Annex to Decision (CFSP) 2024/254, under the heading 'A. Natural Persons', entries number 1, 2, 3, 7 and 8 are replaced by the following corresponding entries:

	Name	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
'1.	María Consuelo PORRAS ARGUETA DE PORRES	Position(s): Attorney General of Guatemala, Head of the Public Ministry (Ministerio Público) of Guatemala DOB: 23.8.1953 Nationality: Guatemalan National identification number: 242159605 (passport) Gender: female	In her position as Attorney General of Guatemala, the highest civil servant in the Public Ministry (Ministerio Público) of Guatemala (equivalent to Head of the Public Prosecutor's Office or Chief Prosecutor), María Consuelo Porras Argueta De Porres (a.k.a. "Porras") is involved in efforts to overturn the results of the first and second rounds of elections held in June and August 2023, including through spurious criminal investigations targeting the Supreme Electoral Tribunal, the political party Movimiento Semilla and President Arévalo. Furthermore, under her leadership the Public Ministry has brought arbitrary proceedings against independent journalists, prosecutors, judges, and civil society activists including indigenous leaders and students. María Consuelo Porras Argueta De Porres is therefore responsible for actions that undermine democracy, the rule of law and the peaceful transfer of power in Guatemala.	2.2.2024

	Name	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
2.	Ángel Arnaldo PINEDA ÁVILA	Position(s): Secretary-General of the Public Ministry (Ministerio Público) of Guatemala DOB: 10.5.1975 Nationality: Guatemalan National identification number: 238937186 (passport) Gender: male	Ángel Pineda Ávila is the Secretary-General of the Public Ministry (Ministerio Público) of Guatemala (equivalent to the Public Prosecutor's Office). He is second-in-command in the Public Ministry after the Attorney General, and Head of the General Secretariat of that institution. In that position, Ángel Pineda Ávila is involved in efforts to overturn the results of the first and second round of elections held in June and August 2023, including through spurious criminal investigations targeting the Supreme Electoral Tribunal, the political party Movimiento Semilla and President Arévalo. In December 2023, he participated in a press conference where the Public Ministry presented claims that the outcome of the first round of elections in June 2023 was invalid. In 2025, Ángel Pineda Ávila engaged in the spurious investigation into indigenous leaders who were accused of terrorism for their actions in defending the 2023 election results. Ángel Pineda Ávila is therefore engaging in actions that undermine democracy, the rule of law and the peaceful transfer of power in Guatemala.	2.2.2024

	Name	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
3.	José Rafael CURRUCHICHE CUCUL	Position(s): Head of the Special Prosecution Office Against Impunity, Public Ministry (Ministerio Público) of Guatemala DOB: 28.7.1970 Nationality: Guatemalan National identification number: 229488307 (passport) Gender: male	José Curruchiche Cucul is the Head of the Special Prosecution Office Against Impunity (FECI), which operates under the Public Ministry (Ministerio Público) of Guatemala (equivalent to the Public Prosecutor's Office). Under his leadership, the FECI spearheaded the ongoing investigation into the creation of the political party Movimiento Semilla of President Arévalo. He personally participated in the raid by the Public Ministry of the premises of the Supreme Electoral Tribunal that entailed the opening of sealed ballot boxes. Additionally, he was involved in the request for the suspension of the legal personality of Movimiento Semilla in July 2023. Furthermore, in December 2023 he participated in a press conference where the Public Ministry presented claims that the outcome of the first round of elections in June 2023 was invalid. He has been personally involved in the spurious investigation into and the spurious prosecution of democratically elected authorities, former representatives of the media (such as journalist José Rubén Zamora), as well as justice operators, especially the spurious investigation into and the spurious prosecution of those who fought against corruption and impunity with the International Commission Against Impunity in Guatemala (CICIG). Through those actions, José Curruchiche Cucul is involved in efforts to overturn the results of the 2023 elections in Guatemala. He is therefore responsible for actions that undermine democracy, the rule of law and the peaceful transfer of power in Guatemala.	2.2.2024

	Name	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
7.	Ricardo Rafael MÉNDEZ-RUIZ VALDÉS	Position(s): President, Foundation against Terrorism (Fundación contra el Terrorismo), FCT Date of birth: 9.10.1959 Nationality: Guatemalan National identification number: 268287872 (passport) Gender: male Associated individuals: Raúl Amílcar Falla Ovalle Associated entities: Foundation against Terrorism (Fundación contra el Terrorismo), FCT Social media: https://x.com/rmendezruiz	Ricardo Méndez-Ruiz Valdés is President of the Foundation Against Terrorism (Fundación contra el Terrorismo), FCT. The FCT is involved in a campaign of politically-motivated prosecutions led by the Guatemalan Attorney General's Office against journalists, indigenous leaders, prosecutors and judges who have been involved in exposing corruption and impunity in Guatemala as well as against the democratically-elected government of Guatemala, including President Bernardo Arévalo. The FCT has initiated a multitude of criminal investigations against justice operators, journalists and representatives of the government through the filing of criminal complaints and by acting as third party plaintiff in criminal proceedings that do not respect the fundamental rights of the defendants. Through those actions, Ricardo Méndez-Ruiz Valdés has engaged in actions that undermine the rule of law in Guatemala, including the persecution and intimidation of representatives of the media, civil society, and of lawyers, judges and prosecutors.	12.6.2025

	Name	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
8.	Raúl Amílcar FALLA OVALLE	Position(s): Legal representative, Foundation against Terrorism (Fundación contra el Terrorismo), FCT Date of birth: 9.11.1971 Nationality: Guatemalan National identification number: 179421166 (passport) Gender: male Associated individuals: Ricardo Méndez-Ruiz Valdés Associated entities: Foundation against Terrorism (Fundación contra el Terrorismo), FCT Social media: https://x.com/RaulFalla31	Raúl Falla Ovalle is the legal representative of the Foundation Against Terrorism (Fundación contra el Terrorismo), FCT. The FCT is involved in a campaign of politically-motivated prosecutions led by the Guatemalan Attorney General's Office against journalists, indigenous leaders, prosecutors and judges who have been involved in exposing corruption and impunity in Guatemala as well as against the democratically elected government of Guatemala, including President Bernardo Arévalo. The FCT has initiated a multitude of criminal investigations against justice operators, journalists and representatives of the government through the filing of criminal complaints and by acting as third party plaintiff in criminal proceedings that do not respect the fundamental rights of defendants. Through those actions, Raúl Falla Ovalle engages in actions that undermine the rule of law in Guatemala, including persecution and intimidation of representatives of the media, civil society, and of lawyers, judges and prosecutors.	12.6.2025*